



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës**



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201600181/11

Tiranë ____/____/2016

Lënda: *Rekomandohet fillimi i hetimit në ngarkim të shtetases Adriana Shehu etj, me detyrë Regjistruese e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Palaujtshme, _____, për kryerjen e veprës penale të "Shpërdorimit të detyrës", parashikuar e dënueshme sipas nenit 248 të Kodit Penal".*

Drejtuar : **Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor**

SARANDË

Për dijeni: **Prokurorit të Përgjithshëm**

TIRANË

Z.Drejtues i Prokurorisë,

Më datën 08.02.2016, shtetasi H.Ç., me banim në Rrugën "Shyqëri Ishmi", Pallati 38, Shkalla 1, Apartamenti 5, Tiranë, (Cel 0692525343) ka depozituar pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, ankesë ndaj Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Palaujtshme, Sarandë, për mosregjistrimin e titullit të pronësisë, Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë Nr. 1208, datë 16.07.2014, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Sarandë, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit, Gjirokastrë, me Vendimin nr. 449, datë 28.10.2014, për të cilin është lëshuar urdhëri i ekzekutimit me Vendimin nr.722, datë 16.07.2014, prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Sarandë, me objekt:

"Anullimin e Vendimit të Komisionit të Kthimit të Pronave Nr.1125, datë 22.08.2013, të Agjensisë së Kthimit dhe Kompesimit të Pronave.

Njohjen e së drejtës së pronësisë subjektit të shpronësuar S.H.Ç dhe kthimin e sipërfaqes prej 1.5/96 pjesë e sipërfaqes totale 11320ha, për sipërfaqen 20.6 ha të ndodhur në Zonën Kadastrale nr.2297 Ksamil, me kufizime (sipas aktit të ekspertimit bashkëngjitur të ekspertit Eshref Liçaj). Detyrimin e ZVRPP të kryejë veprimet përkatëse".

Me rastin e marrjes formë të prerë të vendimit gjyqësor të sipërcituar, rezulton se, një prej trashëgimtarëve të të ndjerit S.H.Ç., zj.L.P.Ç., ka kërkuar ZVRPP, Sarandë, (aplikimi nr. 2644, datë 10.11.2014) regjistrimin dhe lëshimin e dokumentave të pronësisë (sipas kodeve I4, I5, L1 dhe R2) për pasurinë e fituar në pronësi sipas titullit të pronësisë, Vendimit nr. 1208, datë 16.07.2014, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Sarandë.

Sipas *“Listës së shërbimeve në ZVRPP”* afati për dhënien e cilitdo prej shërbimeve të kërkuara nuk është më shumë se 12 ditë. Në aplikimin nr. 2644, datë 10.11.2014, të kryer prej zj.L.Ç është përcaktuar si afat i përfundimit për dhënien e shërbimeve të kërkuara data 18.11.2014.

Në kushtet e mosrespektimit të afatit të vendosur për dhënien e shërbimit të kërkuar, prej trashëgimtarëve të të ndjerit S.Ç., Institucioni i Avokatit të Popullit, duke e vlerësuar qëndrimin e Regjistrueses së ZVRPP, Sarandë, në kundërshtim me parimet mbi të cilat funksionon administrata publik, si; në shkelje të së drejtës së pronësisë për ankuesin, si dhe parimin e ligjshmërisë, drejtësisë dhe paanësisë, deburokratizimit dhe i efijencës, sikurse parashikuar në nenet 4, 13 dhe 18 të Ligjit nr.44/2015, *“Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, të detyrueshme për respektim në kuptim dhe zbatim të nenit 1 dhe 2 të këtij Kodi, ka rekomanduar me shkresën nr.K3/H3-2 Prot, datë 24.02.2016, Regjistrueses së ZVRPP, Sarandë;

“Marrjen e masave të menjëhershme për regjistrimin dhe lëshimin e dokumentave të pronësisë në procesin e ekzekutimit të Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë Nr.1208, datë 16.07.2014, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Sarandë, lënë në fuqi prej Gjykatës së Apelit, Gjirokastër, me Vendimin nr. 449, datë 28.10.2014, dhe Ajo e Lartë me Vendimin nr. 3797, datë 13.11.2015”.

Pa shkak të bërë të ditur, Regjistruesja e ZVRPP, Sarandë, në kundërshtim me afatin ligjor të bërë të ditur prej Avokatit të Popullit në shkresën nr.K3/H3-2 Prot, datë 24.02.2016, nuk ka kthyer përgjigje Institucionit të Avokatit të Popullit rreth rekomandimit të dhënë, edhe pse Ministria e Drejtësisë me shkresën nr.1665/1 Prot, Datë 06.04.2016, drejtuar Regjistrueses së ZVRPP, Sarandë, tërheqë vëmendjen për vonesat në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjes së trashëgimtarëve Ç.

Përpos situatës së parregullt, krijuar prej Regjistrueses të ZVRPP, Sarandë, në procesin e dhënies së shërbimeve, konform aplikimit të kryer prej zj.L.Ç., datë 10.11.2014, konstatohet se, subjekti i kallzuar, në shkresat nr.9027/1 Prot, datë 24.12.2015 dhe nr. 9027/6 Prot, datë 11.05.2016, drejtuar Zyrës Qendrore të Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, shprehet midis të tjerave se : *“ZVRPP, Sarandë, në zbatim të orjentimeve të ZQRPP, Tiranë, për trajtimin e Vendimit Nr.23-2014-1208, Datë 16.07.2014, të Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Sarandë, ... ka verifikuar dokumentacionin ligjor të vendimeve të regjistruara brenda pronës “Kullota e Ksamilit” dhe ka rezultuar se kjo pronë nuk krijon mbivendosje me vendimet e regjistruara, pasi janë vendime me kufijë të përcaktuar ... Sqarojmë se nga verifikimi i kartelave të pasurisë dhe HRT rezulton se pasuria kullotë prej 20.6 ha, disponuar me Vendimin Gjyqësor Nr.23-2014-1208, Datë 16.07.2014, të Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Sarandë, prek pasuri me pronësi “Shtet”.*

Për sa sipër kërkojmë nga ana juaj asistencë tekniko-ligjore në lidhje me kërkesën për regjistrimin e Vendimit Gjyqësor nr. 1208, datë 16.07.2014, të dhënë nga Gjykata e

Rrethit Gjyqësor, Sarandë, i cili ka disponuar për kthimin e sipërfaqes prej 20.6 ha, kullotë, në favor të subjektit S.H.Ç. ”.

Në qëndrimin e shprehur prej Regjistrueses së ZVRPP, Sarandë, nuk konstatohet ekzistenca e shkakut ligjor i cili ka pamundësuar dhe pamundëson regjistrimin e titullit të pronësisë, Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë Nr. 1208, datë 16.07.2014, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Sarandë.

Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor Shtetëror, Zyra e Përmbarimit, Sarandë, në kushtet e pranimit të kërkesës së z.H.Ç., për vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv, Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë Nr. 1208, datë 16.07.2014, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Sarandë, ka lajmëruar ZVRPP, Sarandë, me shkresën nr.92 Prot, datë 11.11.2014, për përmbushjen e detyrimit të vendosur. Ndodhur në kushtet e moskryerjes së veprimeve të mëtejshme përmbimore për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv, Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë nr. 1208, datë 16.07.2014, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Sarandë, Institucioni i Avokatit të Popullit, me Shkresën nr. K3/H3-3 Prot, datë 24.02.2016, ka rekomanduar Zyrës Përmbarimit, Sarandë;

“Kryerjen e veprimeve përmbimore sikurse parashikuar në nenin 606 të K.Pr.C. për ekzekutimin e detyrimeve të vendosura sipas Vendimit nr.1208, datë 16.07.2014, të dhënë prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Sarandë, në favor të shtetasit H.Ç, etj”.

Për situatën në të cilën është ndodhur dhe ndodhet procesi i ekzekutimit të Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë nr. 1208, datë 16.07.2014, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Sarandë, Ministria e Drejtësisë, në cilësinë e organit epror të ZVRPP, Sarandë, ka qenë dhe është e informuar, dhe se në shkresat nr. E 13211 Prot, datë 16.06.2015, drejtuar znj E.B.(Ç), dhe nr.1665/1 Prot, datë 06.04.2016, drejtuar ZQRPP, Tiranë dhe ZVRPP, Sarandë, shprehet midis të tjerave se :

“...Duke marrë në konsiderat dhe rekomandimet e grupit të punës sqarojmë se procedura e regjistrimit të Vendimit nr.722(Gabim duhet 1208), datë 16.07.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Sarandë, lënë në fuqi me Vendimin nr.449, Datë 28.10.2014, nga Gjykata e Apelit, Gjirokastër, do të vijojë pas përfundimit të shqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Lartë dhe rënies së vendimit të pezullimit”.

Referuar Vendimit Nr. 3797, datë 13.11.2015, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, konstatohet se, shkakut ligjor i moskryerjes së veprimeve prej ZVRPP, Sarandë, për dhënien e shërbimit sipas aplikimit nr. 2644, datë 10.11.2014, ka rënë në datën e dhënies së këtij vendimi, dhe po kështu Vendimi datë 19.02.2015, i Gjykatës së Lartë *“Për pezullimin e ekzekutimit të Vendimit nr.1208, datë 16.07.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Sarandë, lënë në fuqi me Vendimin Nr.449, Datë 28.10.2014, nga Gjykata e Apelit, Gjirokastër”*, ka rënë më datë 13.11.2015.

Regjistruesja e ZVRPP, Sarandë, me dashje e në kundërshtim me ligjin, nuk ka kryer dhe nuk kryen veprime për dhënien e shërbimit të kërkuar prej subjektit sipas aplikimit nr. 2644, datë 10.11.2014, qëndrim i cili përbën mospërmbushje të rregullt të detyrës në ushtrimin e funksioneve publike, dhe njëkohësisht dëmtim të interesave të ligjshme të trashëgimtarëve Ç. Me mosveprim, e dashje, Regjistruesja e ZVRPP, Sarandë, nuk ka përmbushur dhe nuk përmbush detyrën, në afatin ligjor të përcaktuar. Ky qëndrimi që është mbajtur dhe mbahet prej Regjistrueses së ZVRPP, Sarandë, në procesin e

ekzekutimit të Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë nr. 1208, datë 16.07.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Sarandë, ka cënuar dhe cënon marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për ekzekutimin e titujve ekzekutiv, të cilat sigurojnë jo vetëm veprimtarinë e rregullt të organit në fjalë, por dhe mbrojtjen e interesave të ligjshme të shtetasve apo të shtetit, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal kundër veprimeve ose mosveprimeve kriminale.

Nga analiza e qëndrimit mosveprues në ushtrimin e funksioneve publike prej Regjistrueses së ZVRPP, Sarandë, shprehem se: Pa shkak të ligjshëm, Regjistruesja e ZVRPP, Sarandë, nuk ka kryer regjistrimin e titullit të pronësisë Vendimit Gjyqësor Civil të formës së prerë nr. 1208, datë 16.07.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Sarandë, në afatin e ligjor të përcaktuar, konform parashikimeve të nenit 193/h të Kodit Civil, nenit 5, 25, 26, 27, 31, 45 të Ligjit Nr.33/2012 *“Për rregjistrimin e pasurive të Palaujtshme”*, të ndryshuar.

Për sa më sipër, bazuar në sanksionimin e nenit 63, pika 3, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave të njeriut nga administrata publike”* dhe parashikimin e kryer në nenin 21 gërma “ç” të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999, *“Për Avokatin e Popullit”* të ndryshuar, se: *“Avokati i Popullit, pas përfundimit të hetimit, i rekomandon Prokurorisë të fillojë hetimet në qoftë se vëren se është konsumuar figura e një veprë penale, ose të rifillojë hetimet e pushuara ose të pezulluara”*,

REKOMANDOJMË

“Fillimin e hetimit në ngarkim të shtetas A.Sh., etj, me detyrë Regjistruese e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Palaujtshme, ..., për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar e dënueshme sipas nenit 248 të Kodit Penal”.

Në përfundim të shqyrtimit të këtij rekomandimi, në përputhje me parashikimin e nenit 22 të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999, *“Për Avokatin e Popullit”*, kthimi i përgjigjes duhet të kryhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese..

Duke besuar në mirëkuptimin Tuaj,

Bashkëlidhur ju dërgojmë dokumentet e mëposhtme:

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI

Konceptoi dhe Daktilografoi
A.Gjoleka